# GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT

Analiza vjetore  Viti 2022

- Analiza vjetore e Gjykatës është reflektim i punës jo vetëm i arritjeve por edhe mangësitë për ti shërbyer gjithsecilit për të përmirësuar punën, për të shprehur mendimet dhe për ti dhënë zgjidhje problemeve të ndryshme.

GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BERAT ËSHTË PËRPJEKUR ME SUKSES TË PËRMBUSHË MISIONIN E SAJ NË DHËNIEN E DREJTËSISË DHE TË MARRË MASA QË TË PËRBALLOJË NDRYSHIMET E SHPEJTA SOCIALE E LIGJORE, LARMISHMËRINË E ÇËSHTJEVE, TEKNOLOGJINË NË ZHVILLIM PËR TË GARANTUAR TRANSPARENCË DHE PËRGJEGJSHMËRI, SI DHE REKRUTIMIN E VAZHDUESHËM TË BURIMEVE NJËRZORE TË NEVOJSHME PËR KRIJIMIN E NJË AMBIENT TË PËRSHTATSHËM PUNE.

PUNA E NJË INSTITUCIONI SI GJYKATA ËSHTË E VLERËSUESHME ME ELEMENTË TË TILLË SI VOLUMI, CILËSIA DHE SHPEJTËSIA E GJYKIMIT JANË ELEMENTËT QË VLERËSOJNË JO VETËM PUNËN Ë GJYQTARËVE POR EDHE PUNËN NË PËRGJITHËSI TË GJYKATËS.

- **Veprimtaria Gjyqësore**
- **Ngarkesa dhe lloji i çështjeve gjyqësore.**
- **Tendenca e ngarkesës me çështje.**
- **Likujdimi/përfundimi i çështjeve.**
    - Çështjet penale themeli
    - Kërkesa penale
    - Kërkesa penale në seancë paraprake
    - Çështjet civile
    - Kërkesat për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes
    - Kerkesat civile
- **Ngarkesa me çështje për gjyqtar.**
- **Shpejtësia në gjykim.**
- **Heqjet dorë nga gjykimi i çështjeve.**
- **Përjashtimet e gjyqtarëve nga gjykimi i çështjeve.**
- **Menaxhimi i Lëvizjes së Çështjeve Gjyqësore**
- Mbikqyrja e progresit të çështjeve.
- Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve gjyqësore.

- Organika e gjyqtarve
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka në organikën e saj 9 gjyqtarë dhe nje Kryetar.
- **Viti 2022**, = 6 gjyqtarë (nga të cilët 1 gjyqtare Klejda Meçi ishte me leje lindje), u largua 1 gjyqtare Lutfije Celami me emërim dhe 1 gjyqtare Adelajda Gjuzi me komandim. Në muajin korrik u emëruar 2 gjyqtar Ardiola Çela dhe Albana Misja .

  Në muajin dhjetor u kthye nga leja e lindjes gjyqtaria Klejda Meçi.
- Aktualisht në Gjykatë janë efektiv 6 gjyqtarë.

# Veprimtaria gjyqësore

| Volumi i Çështjeve viti 2022 | Numri |
|---|---|
| Çështje të mbartura nga 2021 | **1271** |
| Çështje të  reja të rregjistruara në 2022 | **3049** |
| Totali i çështjeve të shqyrtuara 2022 | **4320** |
| Çështje të përfunduara në 2022 | **2985** |
| Çështje të mbartura për 2023 | **1335** |

# Tendenca e çështjeve



## Numri i çështjeve të rregjistruara në total (penale dhe civile)

| Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|
| 4171 | 4733 | 4320 |

## Numri i çështjeve të reja (Penale dhe civile)

| Viti 2020 | Viti 2021 | Viti 2022 |
|---|---|---|
| 3330 | 3471 | 3049 |

## Numri i çështjeve të përfunduara penale dhe civile

| Vitit 2020 | Vitit 2021 | Vitit 2022 |
|---|---|---|
| 2909 | 3462 | 2985 |

## Numri i çështjeve të papërfunduara penale dhe civile

| Vitit 2020 | Vitit 2021 | Vitit 2022 |
|---|---|---|
| 841 | 1262 | 1335 |

# Lloji i çështjeve të mbartura në vitin 2023

| Lloji i çështjeve të mbartura | Nr. i çështjeve të mbartura |
|---|---|
| Penale themeli | 139 |
| Seanca paraprake | 150 |
| Kërkesa penale administrative | 62 |
| Civile themeli | 918 |
| Civile të veçanta | 15 |
| Urdhëra ekzekutimi | 48 |
| Urdhëra mbrojtje | 3 |
| **Totali** | **1335** |

# Të ndara sipas gjyqtarëve

| Nr. | GJYQTARËT | Numri i çështjeve papërfunduar në dt. 31.12.2022 |
|---|---|---|
| 1. | Ardiola Çela | 242 |
| 2. | Entela Gjoni | 384 |
| 3. | Matilda Llangozi | 209 |
| 4. | Klejda Meçi | 21 |
| 5. | Albana Misja | 235 |
| 6. | Pëllumb Zaimi | 244 |
| | **TOTALI** | **1335** |

# Të dhëna për çështjet penale themeli

| Nr. | Natyra e çështjeve | Numri i çështjeve të rregjistruara në vitin 2022 | Numri i çështjeve të zgjidhura në vitin 2022 | Numri i çështjeve mbartur per vitin 2022 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Penale themeli krime | 393 | 302 | 91 |
| 2 | Penale themeli kundravajtje | 152 | 104 | 48 |

# ▸Të dhëna për të dënuarit






- Tendencë në rritje  për vitin 2022  kanë qënë  veprat penale të “Kultivimit të bimëve narkotike, , “Shkeljes së rregullave të qarkullimit rrugor”, “ Armëmbajtje pa leje” dhe “ vjedhjes së energjisë elektrike” . Ndërsa veprat me rrezikshmëri të lartë shoqërore si  “vrasje” dhe “vrasje në rrethana cilësuese” apo veprat penale si “Drejtim mjeti në mënyrë të parregullt”, “ Ndërtim pa leje, “Vjedhje”  vërehet një rënie  gjatë vitit 2022.

# Të dhëna për masën e dënimit

| Dënimi | Numri i personave të dënuar në vitin 2022 |
|---|---|
| Me gjobë | 27 |
| Burgim deri në dy vjet. | 351 |
| Burgim nga 2 deri ne 5 vjet. | 29 |
| Burgim nga 5 deri ne 10 vjet. | 1 |
| Burgim nga 10 deri ne 25 vjet. | 3 |
| Burgim nga 25 deri ne 35 vjet | 1 |
| Burgim i përjetshëm | 0 |
| Masë mjeksore | 1 |
| **TOTALI** | **413** |
| Aplikimi i nenit 58 | 0 |
| Aplikimi i nenit 59 | 223 |
| Aplikimi nenit 59/a | 3 |
| Aplikimi i nenit 63 | 51 |

# Të dhëna për seancat paraprake

| Lloji i kërkesës | Pranuar | Pranuar gjykim shkurtuar Kaluar themel | Pushuar | Kthyer për plotësim hetimi | Të tjera | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Dërgim në gjyq/Pushim | 44 | 308 | 102 | 12 | 12 | **478** |

- Të dhëna për çështjet civile të rregjistruara
- Civile themeli 1672
- Të ndryshme civile 126
- Urdhër mbrojtje 190
- Urdhëra ekzekutimi 610

| Nr | Natyra e çështjeve | Numri i çështjeve të rregjistruara në vitin 2022 | Numri i çështjeve të zgjidhura në vitin 2022 | Numri i çështjeve mbartur per vitin 2022 |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Civile themeli me palë | **568** | **162** | **406** |
| 2 | Familjare me palë | **298** | **231** | **67** |
| 3 | Zgjidhje martese | **761** | **415** | **346** |
| 4 | Tregtare me palë | **3** | **0** | **3** |
| 5 | Marrëdhënie pune | **40** | **16** | **24** |

# Të dhëna për urdhërat e mbrojtjes

| **Lloji i kërkesave për lëshimin e urdhërit të mbrojtjes** | **Numri** | **Pranuar** | **Pushuar** | **Refuzuar** |
|---|---|---|---|---|
| Urdhër i zakonshëm mbrojtjeje | 2 | 1 | 1 | 0 |
| Urdhër i menjëhershëm mbrojtjeje | 184 | 32 | 92 | 56 |
| Urdhër mbrojtje menjëhershem paraqitur nga i mituri | 4 | 1 | 1 | 2 |
| Totali | 190 | 34 | 94 | 58 |

# Ngarkesa e gjyqtarëve për vitin 2022

| Nr. | Gjyqtar: | Mbartur nga 2021 | Numri i çështjeve të reja në viti 2022 | Numri i çështjeve të përfunduara në viti 2022 | Numri i çështjeve të mbartura në viti 2023 |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Lutfije Celami | 90 | 139 | 229 | 0 |
| 2 | Ardiola Çela | 4 | 395 | 157 | 242 |
| 3 | Entela Gjoni | 383 | 670 | 669 | 384 |
| 4 | Adelajda Gjuzi | 107 | 208 | 315 | 0 |
| 5 | Matilda Llangozi | 332 | 591 | 714 | 209 |
| 6 | Klejda Meçi | 0 | 32 | 11 | 21 |
| 7 | Albana Misja | 2 | 398 | 165 | 235 |
| 8 | Pëllumb Zaimi | 353 | 616 | 725 | 245 |
| 9 | Te komanduar | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | **SHUMA** | **1271** | **3049** | **2985** | **1335** |

- Numri I çështjeve të përfunduara për çdo gjyqtar



# Shpejtësia në gjykimin e çështjeve

| Kategoria e Çështjeve | Afatet e përfundimit të çështjeve për vitin 2022 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | 1-6 Muaj | 7-12 Muaj | 1-2 Vjet | > 2 Vjet |
| Civile të përgjithshme | 56 | 33 | 53 | 20 |
| Familjare | 369 | 190 | 80 | 7 |
| Marrëdhënie pune | 4 | 7 | 5 | 0 |
| Kërkesa pa kundërshtarë | 636 | 138 | 14 | 2 |
| **GJITHSEJ CIVILE** | **1065** | **368** | **152** | **29** |
| Penale themeli (krime) | 271 | 17 | 14 | 0 |
| Penale themeli (kundervajtje) | 86 | 9 | 6 | 3 |
| Kërkesa administrative penale | 922 | 31 | 10 | 2 |
| **GJITHSEJ PENALE** | **1279** | **57** | **30** | **5** |
| **TOTALI I ÇËSHTJEVE** | **2344** | **425** | **182** | **34** |

## Norma e likujdimit te ceshtjeve civile Treguesi CR



# Norma e likujdimit te ceshtjeve penale Treguesi CR



- Koha e nevojshme per zgjidhjen e ceshtjes civile Treguesi DT



- Koha e nevojshme per zgjidhjen e ceshtjes penale Treguesi DT



- Kërkesat për heqje dorë nga gjykimi i çështjeve

| Kërkesa për heqje dore | Disponimi | | |
|---|---|---|---|
| | **Pranuar** | **Rrëzuar** | **Gjithsej** |
| Kërkesa për heqje dorë civile | 29 | 1 | 30 |
| Kërkesa për heqje dorë penale | 21 | 1 | 22 |
| **TOTALI** | **50** | **2** | **52** |

# Kerkesat për përjashtimin e gjyqtarëve paraqitur nga palët

| Kërkesa për përjashtim të gjyqtarëve | Çështje të përfunduara në vitin 2022 | | | |
|---|---|---|---|---|
| | **Pranuar** | **Rrëzuar** | **Mospranim** | **Gjithsej** |
| Kërkesa për përjashtim Civile | 0 | 7 | 0 | 7 |
| Kërkesa për përjashtim penale | 2 | 6 | 3 | 11 |
| **TOTALI** | **2** | **13** | **3** | **18** |

- Menaxhimi I çështjeve gjyqësore

- Duke patur parasysh rekomandimet e Bashkimit Europian dhe Keshillit te Europes ne projektet SEJ (Mbeshtetje per efikasitetin e Drejtesise) dhe CEPEJ (Komisioni Europian per efikasitetin e Drejtesise) jane organizuar takime të përbashkëta me drejtuesit e Prokurorisë, Dhoma Vendore e Avokatisë, Drejtorisë së Policisë, Bashkia Berat, drejtuesit e institucioneve lokale të Qarkut Berat në vazhdim të nismës “Drejtësi Pa Vonesa”.

- Në kuadrin e njoftimit të palëve Gjykata ka marrë masa për hartimin e një formulari ku palët të shprehin dëshirën që njoftimi i tyre të bëhet nëpërmjet numrit të kontaktit ose postës elektronike. Kjo do të sillte ulje të shpenzimeve postare. Për këtë në vazhdimësi do të organizojmë një takim me Dhomën e Avokatisë Berat për të bashkërenduar punën.

- Sistemi elektronik I Menaxhimit të çështjeve ICMIS
- Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat që prej viti 2008 aplikohet sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS. Pavarësisht problematikave të evidentuara në mënyrë të vazhdueshme për funksionimin e këtij sistemi dhe disa zgjidhjeve të ofruara në vijimësi, ende mbeten për zgjidhje disa problematika, ku ndër më kryesoret renditen:
- **mosgjenerimi i të dhënave statistikore** të sakta dhe sipas modelit të kërkuar, në funksion të statistikave të kërkuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Ministria e Drejtësisë, apo të nevojshme për një menaxhim aktiv të qarkullimit të çështjeve;
- **mospërshtatja me ndryshimet ligjore në K.Pr.Civile dhe K.Pr.Penale** përsa i përket gjykimeve në dhomë këshillimi, regjistrimit të kërkesave të seancës paraprake dhe gjykimeve të reja të posacme si Urdhëri Penal dhe Marrëveshja për pranimin e fajësisë etj, por edhe cilësimit të palëve.
- **Mospërshtatjë e rregjistrave elektronik me ato manual**

- Të dhëna për rregjistrimin audio të seancave gjyqësore gjatë vitit 2022

| Nr. | Gjyqtari | Seanca të regjistruara audio (SA) | Seanca të paregjistruara (SP) | Gjithsej (TOT) |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Lutfije Celami | 243 | 145 | 388 |
| 2 | Ardiola Çela | 423 | 55 | 478 |
| 3 | Entela Gjoni | 2118 | 806 | 2924 |
| 4 | Adelajda Gjuzi | 313 | 147 | 460 |
| 5 | Matilda Llangozi | 1923 | 740 | 2663 |
| 6 | Klejda Meçi | 14 | 4 | 18 |
| 7 | Albana Misja | 394 | 123 | 517 |
| 8 | Pëllumb Zaimi | 1804 | 534 | 2338 |
| | **SHUMA** | **7232** | **2554** | **9786** |

- Paraqitja grafike e seancave audio në  përqindje sipas gjyqtarëve



- Menaxhimi administrative I gjykatës
- Viti 2022 vazhdoi me të njëjtën organikë si viti 2021, ku kishim disa shtesa e cila përbëhet nga  10 gjyqtarë dhe 24 punonjës të administratës gjyqësore, nga të cilët 1 kancelar, 1 kryesekretare, 1 sekretare regjistruese, 13 sekretare gjyqësore, 1 specialist IT, 1 Specialiste për marrëdhënien me publikun dhe median, 1 arkiviste, 1 Kryetare degës së Buxhetit, 1 magaziniere-arkëtare, 1 punonjës sigurie, 2 ftues gjyqësor, 1 sanitare, 1 shofer /mirëmbajtës.
- Nga ky numër në organikë efektiv kishim 6 gjyqtarë dhe 22 punonjës administrate. Në muajin shtator përfundoi procedura e magazinieres dhe në muajin nëntor përfundoi procedura e ftuesit gjyqësor dhe numri shkoi në 24 punonjës të administratës gjyqësore.

- Teknologjia e informacioni
- Të gjithë gjyqtarët dhe administrata kanë në dispozicion pajisje të teknologjisë së informacionit që plotësojnë nevojat e punës së tyre në gjykatë. Në mënyrë periodike është bërë rifreskimi i këtyre pajisjeve. Të gjithë zyrat e gjyqtarëve, janë të pajisur me PC dhe printera, pasi kjo ndihmon në punën e përditshme të gjyqtarëve,
- Do të shikojmë mundësinë e pajisjes së zyrës së ftuesave me skaner pasi kjo  ndihmon në punën e përditshme për dërgimin elektronikisht të njoftimeve, sidomos në IEVP-të për shoqërimin e të pandehurëve që ndodhen në këtë institucion.

- Shorti elektronik
- Sistemi elektronik i menaxhimit të çështjeve ICMIS mundëson përveç të tjerash ndarjen e çështjeve ndërmjet gjyqtarëve, me short elektronik. Kërkesat e vendimit nr. 554 datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë "Për procedurat e ndarjes së çështjeve me short" janë respektuar dhe do vazhdojnë të respektohen në vazhdimësi në mënyrë rigoroze në lidhje me ndarjen e çështjeve me short si dhe është rritur transparenca e këtij procesi, duke u publikuar paraprakisht koha e realizimit të shortit.
- Nga të dhënat statistikore rezulton se çështjet janë shpërndarë në mënyrë përafërsisht të barabartë për të gjithë gjyqtarët. Diferencat justifikohen duke patur parasysh numrin e çështjeve të regjistruara gjatë gadishmërisë së secilit gjyqtar, që mund të ketë qenë jo i barabartë apo dhe dinamika e mbylljes së çështjeve që përfundojnë.

- Aksesi dhe transparenca
- Në përputhje me nenin 7 të ligjit nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit" është përgatitur, programi i transparencës për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ndërton dhe rrit transparencën në punën e saj institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program, synon të bëjë transparencën e veprimtarisë së punës së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, nëpërmjet pasqyrimit të tij në faqen zyrtare http://www.gjykataberat.gov.al, . Gjithashtu është në përdorim faqa e emailit të Gjykatës me adresë gjykataberat@gmail.com si dhe faqa e Gjykatës ne rrjetin social Facebook, duke rritur aksesin nga pjesëmarrës të tjerë të interesuar si palët, avokatët mbrojtës, media. Herë pas here shpërndahen fletëpalosje për shërbime të ndryshme për ti ardhur në ndihmë publikut për të marrë informacionin e nevojshëm, kjo në kuadër dhe të planit të komunikimit të hartuar nga KLGJ.

- Ofrimi i shërbimit nga administrata gjyqësore
- **KRYESEKRETARIA DHE SEKRETARIA** gjyqësore janë funksionet që kanë qenë më shumë të ngarkuar. Vlen të theksohet ngarkesa shumë e lartë me çështje për secilin gjyqtar , numri total i seancave në vit dhe për rrjedhim ngarkesa e lartë në punë e secilës sekretare gjyqësore.
- Primar  mbetet ofrimi i një  një shërbimi sa më të shpejtë dhe korrekt ndaj publikut. Të shikohet mundësia e pjesëmarrjes në seminare i administratës gjyqësore = kërkohen trajnime për adminsitratën në drejtim të performancës, etikës së komunikimit, organizimit të punës dhe shërbimit ndaj qytetarëve.
- **ARKIVA**:. Problematikë vijon të mbetet mungesa e hapësirave të nevojshme për sistemimin dhe inventarizimin e dosjeve arkivore në ambientet e arkivës. Në pamundësi absolute të hapësirave të nevojshme, arkiva penale dhe civile është e shpërndarë në disa ambiente të ndryshme të gjykatës.

- Infrastruktura dhe siguria

- Infrastruktura ngelet një nga shqetësimet tona në vazhdimësi . Godina e Gjykatës aktualisht me dy kate nuk i plotëson kushtet për të qënë një gjykatë me standarte, për zhvillimin normal të punës pasi nuk ka ambiente pune të mjaftueshme në krahasim me numrin e punonjësve. Gjithashtu nuk ka salla gjyqi të mjaftueshme për numrin e gjyqtarëve. Gjykata ka vetëm një hyrje si për gjyqtarët, administratën, palët ndërgjyqëse dhe për publikun.
- Në vitin 2022 janë marrë masa për përmirësim në drejtim të sistemit të monitorimit të lëvizjeve në ambientet e brendshme të gjykatës me kamera. Gjithashtu janë marrë masa për monitorimin dhe mirëfunksionimin e sistemit të integruar për mbrojtjen nga zjarri, përmbytjet dhe rreziqe të tjera.
- Gjatë vitit 2022 janë marrë masat për vendosjen e një pajisje dedektor në hyrje të derës kryesore të Gjykatës me qëllim evidentimin e rasteve dhe personave që mund të vënë në rrezik jetën e gjyqtarëve , administratës por edhe të godinës. Gjithashtu në të dy katet ne koridoret ne katin e dytë ku hyjnë gjyqtarët për në zyra dhe në katin e parë ku hyn administrata në ambientet e punes janë vendosur dyer me pajisje ku hyrja e punonjësve bëhet nëpërmjet kartës.

- Menaxhimi i fondeve publike për vitin 2022
- Gjatë vitit 2022 Gjykata e Rrethit Gjyqesor Berat,  ka funksionuar me 28 punonjes dhe për kete numer ka shpenzuar nje fond page + sigurime = 44.078.690 lekë nga 47.408.000 lekë që ishte plani i buxhetit te shtetit për këto zera, ose në përqindje realizuar 93 %.
- Për shpenzimet operative është çelur nje fond nga buxhetit i shtetit në vlerën 8.000.000 lekë per vitin 2022, i cili është realizuar në masën  7.966.210 leke, ose  matur ne përqindje eshte realizuar 99.6 %.
- Përdorimi i këtij fondi është shpërndarë si më poshtë:
- **33 %** e fondit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve për shërbime të përgjithshme si energji, postë, ujë, internet etj. respektivisht në vlerën 2.610.660 lekë.
- **19 %** e fondit është përdorur për shërbim avokatie, ekspert, psikolog, përkthyes, ose 1.522.550 lekë
- **48 %** e fondit është përdorur për mbulimin e shpenzimeve për materiale zyre si letër, tonera, kancelari,shtypshkrime, shpenzime per transport, mirëmbajtje të paisjeve elektronike, godine, taksa bashkie,dieta etj. respektivisht në vlerën 4.133.210 leke.

- Marrëdhëniet me institucionet e tjera
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat ka bashkëpunuar në mënyrë të vazhdueshme me institucionet si Këshilli i Lartë Gjyqësor, Ministria e Drejtësisë dhe Shkolla e Magjistraturës me qëllim plotësimin e kërkesave dhe marrjen e masave për trajtimin e ankesave, kryerjen e procesit të hartimit dhe administrimit të statistikave dhe ndjekjen e trajnimit vazhdues të gjyqtarëve dhe administratës gjyqësore. Për vitin 2022 gjyqtarët kanë ndjekur trajnimet vazhduese të organizuara kryesisht nga Shkolla e Magjistraturës.
- Jane zhvilluar takime  me drejtuesi si me Drejtorin e Policisë, Drejtorin e Degës Rajonale të Shërbimit të Provës  Berat. Në vazhdimësi do të zhvillojmë takime me drejtuesin e  Filialit Postës Berat, drejtuesen e  ASHK zyra vendore Berat dhe me institucione të tjera me të cilët gjykata ka marrëdhënie institucionale.

# JU FALEMINDERIT PËR VËMËNDJEN

# DHE JU UROJ SUKSESE NË PUNËN TUAJ